



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

05-Nr 432-32754/2019

Klinë, datë 02.08.2019

**NJOFTIM ME RËNDËSI PËR TATIMPAGUESIT E TATIMIT NË PRONË
NË KOMUNËN E KLINËS**

Ftoheni te Regjistroni numrin tuaj personal

Duke regjistruar numrin tuaj personal në Zyrën e tatimit në pronë, ju do të keni përfitime si dhe mundësinë për të shfrytëzuar shërbimet elektronike dhe marrjen e vetëm një faturë për të gjitha pronat në komunën e Klinës.

Shërbimet e tatimit në pronë synojnë që të jenë moderne dhe efikase. Regjistrimi i numrit personal shpie në efikasitet dhe informata më të sakta dhe të besueshme në regjistra të tatimit në pronë.

Për ju si tatimpagues, ka shumë përfitime nga regjistrimi i numrit personal në regjistrat e tatimit në pronë:

- Përfitim nga zbritja për vendbanimin parësor. Zbritja për banim primar nga viti 2019 është 15.000 €
- Vetëm një faturë për të gjitha pronat tuaja në komunë, e cila dërgohet në një adresë.
- Vetëm një provizion në bankë kur të paguani tatimin në pronë për të gjitha pronat tuaja brenda komunës.
- Reduktimi i rrezikut nga pagesa e gjobave dhe interesit për shkak të mos-dorëzimit të faturës tek ju.
- Më pak rrezik të faturave të dyfishta për pronën e njëjtë.
- Përfitimi nga shfrytëzimi i shërbimeve tona elektronike. Në këtë mënyrë, ju mund të qaseni në të gjitha faturat dhe certifikatat tuaja kurdo që doni dhe pavarësisht nëse keni prona në shumë komuna apo jetoni jashtë.

Ju lutemi, vëreni se për të përfituar zbritjen për vitin 2020 për banim primar prej 15.000 € është e domosdoshme të sjellni dhe të regjistroni numrin tuaj personal në Zyrën e tatimit në pronë të Drejtorisë për financa, ekonomi dhe zhvillim, më se voni deri me 30 nëntor 2019. Pas kësaj date, në mungesë të numrit personal, zbritja nuk do të llogaritet dhe do të paguani më shumë tatim.



Drejtori:

Aziz Desku